



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr.

Datë

Për

Miratimin e dokumentacionit dhe procedures për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe VKM nr.666 datë.10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Këshilli i Bashkisë

Vendosi

1. Të miratojë dokumentacionin për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike si më poshtë:

- **Sipas pikës 2.1 Kriteri ekonomik**

Dokumentat që nevojiten për të aplikuar sipas këtij kriteri të jenë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga konviktet (mbi regjistrimin apo pamundesinë për akomodim);
- Vërtetim të ardhurash/page për çdo anëtar madhor të familjes (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim pagese pensioni pleqërie (shkarkohet nga e-albania, tek rubrika Kontributet dhe pensioni; Vërtetim pensioni);

- **Sipas pikës 2.3 Kriteri joekonomik**

a) nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

b) Nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë. Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

c) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjekoligjor; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes; (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

ç) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes;

- (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);
- Vërtetim mbi statusin që nuk shikojnë apo dëgjojnë; (Mund të shkarkohet nga e-albania ose të merret Vërtetim me vulë të njomë nga Njësia Administrative);

d) nxënësit, fëmijë të personit/personave (prindit/prindërve) që gëzojnë statusin e invalidit; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim mbi statusin e invaliditetit dhe pagesën e pensionit të invaliditetit të prindërve. (Mund të shkarkohet nga e-albania ose të merret tek Njësia Administrative);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);
- Vërtetim mbi statusin e viktimave të trafikimit;
- Vendim gjyqësor mbi humbjen e kujdestarisë prindërore;

ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);

- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);
- Vërtetim nga institucionet e sipërpërmendura për prindërit që kanë humbur jetën në krye të detyrës;

g) Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton. Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare, ku vërtetohet gjëndja familjare me një prind gjallë e fëmijës/nxënësit (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë e vdekjes së prindit që nuk jeton;
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes. (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

2. Dokumentacioni që ka lidhje me regjistrimin si punëkërkues i papunë për çdo anëtar madhor të familjes, vërtetimi mbi statusin e jetimit dhe pagesën e kujdestarisë si dhe vërtetimi mbi statusin e invaliditetit paraplegjik dhe pagesën e PAK, do i vendoset në dispozicion NSHMAÇ nga Drejtoria e Kujdesit Social.

3. Të miratojë procedurën për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike si më poshtë:

- a) Procedura fillon me protokollimin e shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit pranë Bashkisë Korçë, në muajin Shtator.
- b) Në datën 1 tetor bëhet afishimi i njoftimit në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë, në ambjentet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes dhe në të gjitha shkollat.
- c) Brenda 25 ditëve nga afishimi i njoftimit drejtoritë e shkollave do të pranojnë aplikime për bursa.
- d) Drejtoritë e shkollave për çdo aplikim duhet të mbajnë procesverbal dhe do e pranojnë dosjen e aplikantit vetëm nëse do të jetë e plotësuar nga ana formale me të gjitha dokumentat, bazuar në kriterin në të cilin klasifikohet nxënësi dhe sipas këtij vendimi. Në procesverbal do të pasqyrohet dhe data kur është dorëzuar dosja pranë drejtorisë së shkollës.

- e) Pas përfundimit të afatit të njoftimit drejtorët e shkollave do të dorëzojnë me procesverbal pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes të gjithë dokumentacionin e mbledhur.
 - f) Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga shkollat Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes do të përcjellë me shkresë numrin e aplikimeve në Ministrinë Arsimit dhe Sportit.
 - g) Nga drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes do të ngrihet grupi i punës i cili do të verifikojë nga ana formale dhe e vlefshmërisë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar dhe do të përgatitë listën e përfituesve të bursave.
 - h) Në rast se numri i përfituesve ,sipas listës së sipërpërmendur ,është më i lartë se numri i bursave të akroduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, do të përfitojnë bursë ata nxënës që kanë dorëzuar më parë aplikimin pranë shkollës.
 - i) Rast pas rasti, në varësi dhe të buxhetit , Bashkia mund të mbështesë me bursa ata aplikantë të cilët nuk mbulohen nga fondi i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, por që dokumentacioni i dorëzuar prej tyre është i rregullt dhe brenda afatit të dorëzimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen NSHMAÇ, Drejtoria e Kujdesit social, drejtoritë e shkollave 9-vjeçare , të mesme të përgjithshme dhe grupi i punës që do të shqyrtojë dokumentacionin e dorëzuar .
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore).

Sekretari i Keshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me _____vota

Vota Pro_____

Vota Kunder_____

Vota Abstenim_____

Zbardhur me datë_____

KRYETAR

Ana VERUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1081/prot.

Tiranë, më 19.08.2025

Lënda: Kthim përgjigje.

BASHKISË KORÇË
Rruga "Dhimitër Drenasi",
KORÇË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 6737 prot., datë 09.07.2025, protokolluar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me nr. 1081 prot., datë 11.07.2025, me anë të së cilës kërkon mendim për relacionin dhe projekt vendimin për "*Miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike*", na lejoni t'ju informojmë sa më poshtë vijon:

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Referuar nenit 32, pika 1 të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë:

- a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin "*Për barazinë gjinore në shoqëri*";
- b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- ç) të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- d) të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- dh) të monitorojë zbatimin e këtij ligji, si dhe të ligjit "*Për barazinë gjinore në shoqëri*";
- e) të kryejë sondazhe në lidhje me diskriminimin;

- ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
- f) të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- g) t'i drejtohet drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- gj) me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtojë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- h) të kontribuojë në raportimet dhe sipas rastit të paraqesë raporte para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë;
- i) të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- i/1) të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;
- j) të informojë për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- k) të zhvillojë dialogun e rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- l) të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Sipas informacionit të administruar gjatë shqyrtimit të ankesave¹ të ardhura nga prindërit e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, fëmijët e tyre janë përjashtuar nga përfitimi i bursave të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike.

Në përfundim të trajtimit të ankesave të sipërcituara, në 42 raste, Komisioneri konstatoi se fëmijët e subjekteve ankues, janë diskriminuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke dështuar të trajtohen me bursa, referuar parashikimeve të VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 "*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*", të ndryshuar.

Gjithashtu, në analizë të rasteve të trajtuara nga Komisioneri, u evidentuan problematikat sa më poshtë vijon:

- mungesa e një akti administrativ ku të ishin përcaktuar qartë kriteret dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 "*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*", të ndryshuar;
- mungesa e një procedure të qartë për trajtimin me bursa ku aplikantët të pajiseshin me një dokument, përmes së cilit të vërtetohej fakti i aplikimit, dorëzimit të dokumentacionit përkatës dhe kërkesa për përfitimin nga kriteri specifik sipas VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 "*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e*

¹ 61 (gjashtëdhjetë e një) ankesa

të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar;

- në dokumentacionin e kërkuar aplikuesve, si në rastet kur ata trajtoheshin me ndihmë ekonomike, pagesë paaftësie apo kishin statusin e jetimit, nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, është kërkuar edhe dokumentacion që disponohet nga institucionet vartëse të tyre, dhe në këto raste, mosdorëzimi i këtyre dokumenteve nga aplikuesit ka rezultuar në përjashtimin e aplikimeve për bursë;
- kërkesa e lidhur me dokumentacionin që duhet dorëzuar nga aplikantët sipas kriterëve të pikës 2.1/c, të VKM-së sipër cituar, konkretisht të vërtetimit nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes, të cilin e dispononin njësitë e vetëqeverisjes vendore, në dosjet e personave që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike, u konstatua kërkesë e tepërt dhe e panevojshme duke qenë se administrohet prej tyre, si dhe krijonte për aplikantët një barrë të tepërt;
- nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ishte interpretuar në mënyrë të gabuar pika 2.1, shkronja c), të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, duke trajtuar me bursë nxënësit në pamundësi financiare, pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë. VKM-ja përcakton shprehimisht se: “... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”. Pra, kushti kumulativ dhe cilësimet: pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, janë togfjalësh të shtuar nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe që nuk citohen në pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së. VKM-ja nr. 666, datë 10.10.2019 e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë, në pamundësi financiare.
- në disa çështje të paraqitura në fund të 2024, të cilat më pas u zgjidhën, u konstatua problematika që institucionet arsimore, të cilat pretenduan se ishin udhëzuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk pranonin aplikimet/dokumentacionin në rast se familjet trajtoheshin me ndihmë ekonomike.

Për sa më lartë dhe në analizë të Relacionit “Për miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”, të përcjellë nga ana juaj, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për mendim, keni parashikuar dokumentet që nevojiten për të aplikuar sipas kriterëve respektive të parashikuara nga VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, ku ndër të tjera keni përcaktuar se:

- Sipas pikës 2.1 “Kriteri ekonomik”, veç dokumentacionit që përcaktohet në VKM, është kërkuar “Vërtetim regjistrimi si punëkërkues i papunë për çdo anëtarë madhor të familjes të papunë”;
- Sipas pikës 2.3 “Kriteri joekonomik”, veç dokumentacionit që përcaktohet në VKM, për kategorinë “b) Nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë” është kërkuar “Vërtetim mbi statusin dhe pagesën e Kujdestarisë”;
- Sipas pikës 2.3 “Kriteri joekonomik”, veç dokumentacionit që përcaktohet në VKM, për kategorinë “c) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjekoligjor;” është kërkuar “Vërtetim mbi statusin e invaliditetit, para-tetraplegjik dhe pagesën e PAK”.

Duke ju referuar vendimmarrjes së Komisionerit, është konstatuar se në dokumentacionin e kërkuar aplikuesve, si në rastet kur ata trajtoreshin me ndihmë ekonomike, pagesë paaftësie apo kishin statusin e jetimit, nga ana e njësitë të vetëqeverisjes vendore, është kërkuar edhe dokumentacion që disponohet nga institucionet vartëse të tyre, dhe në këto raste, mosdorëzimi i këtyre dokumenteve nga aplikuesit ka rezultuar në përjashtimin e aplikimeve për bursë. Pra, nga Komisioneri është konstatuar se kërkesat për dorëzimin e dokumentacionit të cituar më sipër, janë të tepërta dhe të panevojshme duke qenë se administrohen nga Bashkia Korçë, si dhe krijojnë për aplikantët një barrë të tepërt. Në këtë kuptim, theksojmë se relacioni *“Për miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”*, duhet rishikuar duke reflektuar në to, konstatimet e mëparshme të Komisionerit në vendimmarrjet e tij, si dhe analizën e sipër cituar.

Gjithashtu, në se në mbyllje të relacionit *“Për miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”*, është parashikuar procedura për pranimin dhe shqyrtimin e aplikimeve për bursa, sipas një rendi të përcaktuar në dokument. Ndër të tjera evidentohet se në pikën 4, përcaktohet se: *“Drejtoritë e shkollave për çdo aplikim duhet të mbajnë procesverbal dhe do e pranojnë dosjen e aplikantit vetëm nëse do të jetë e plotësuar me të gjitha dokumentet, bazuar në kriterin në të cilin klasifikohet nxënësi dhe sipas këtij vendimi. Në procesverbal do të pasqyrohet dhe data kur është dorëzuar dosja pranë drejtorisë së shkollës.”*

Duke ju referuar problematikave të konstatuara më parë dhe për sa është parashikuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, është evidentuar se drejtoritë e shkollave nuk duhet të kenë rol vendimmarrës në pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kërkuar aplikuesve, por ato duhet të pranojnë dhe të mbajnë procesverbalin përkatës me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët dhe më pas përcjelljen e tij në njësitë të vetëqeverisjes vendore përkatëse. Në këtë kuptim, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të jenë ato të cilat kanë rolin vendimmarrës nëpërmjet organeve përkatëse, për shqyrtimin e dokumentacionit dhe analizimin e tij, referuar kriterëve të vendosura. Sa më sipër, theksojmë se pika 4 e relacionit në të cilën është parashikuar procedura për pranimin dhe shqyrtimin e aplikimeve për bursa, duhet rishikuar duke reflektuar në të, rolin e drejtorive të shkollave të cilat kanë përgjegjësi në pranimin dhe mbajtjen e procesverbalit me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët dhe më pas përcjelljen e tij në njësitë të vetëqeverisjes vendore përkatëse. Gjithashtu, theksojmë se në kuadër të transparencës, një kopje e procesverbalit të mbajtur nga ana e drejtorive të shkollave t’i vihet në dispozicion aplikuesve në momentin e dorëzimit të dokumentacionit përfundimtar.

Sakaq, duke ju falënderuar për punën dhe bashkëpunimin e ofruar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju inkurajon t’i drejtoheni institucionit, sa herë që të jetë e nevojshme për dërmarrjen e nismave me interes publik në nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Robert GAJDA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE E ARSIMIT DHE ÇERDHE

Nr. _____ prot.

Korçë, më ____ . ____ . ____

RELACION

Për

Miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike

Miratimi i dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave vjen si pasojë e situatës me të cilën jemi përballur, përkatësisht dy vitet e fundit 2023-2024 dhe 2024-2025 ku numri i aplikimeve ka qënë 600-700 aplikime në vit dhe kuota për bursa ka pasur vetëm 350. Në lidhje me përzgjedhjen e fituesve ne jemi bazuar në kriteret e VKM-së nr.666 datë 10.10.2019 të ndryshuar dhe në listën e dokumentacionit që aplikohet nga të gjitha bashkitë e vendit. Kjo ka sjellë pakënaqësi nga aplikantët dhe në disa raste është trajtuar si diskriminim nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për këto arsye dhe në zbatim të përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.666 datë.10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, propozojmë të miratohet dokumentacioni për secilin kriter dhe procedura që nga aplikimi e deri në përcjelljen e dokumentacionit pranë Këshillit Bashkiak, si më poshtë:

- Sipas pikës 2.1 Kriteri ekonomik

- a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, dhe që akomodohen në konvikte publike;
- b) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, dhe që akomodohen në konvikte publike;
- c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

Dhe dokumentat që nevojiten për të aplikuar sipas këtij kriteri janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga konviktet (mbi regjistrimin apo pamundesinë për akomodim);
- Vërtetim të ardhurash/page për çdo anëtar madhor të familjes (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim pagese pensioni pleqërie (shkarkohet nga e-albania, tek rubrika Kontributet dhe pensioni; Vërtetim pensioni);

- Sipas pikës 2.3 Kriteri joekonomik

a) nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

b) Nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë. Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

c) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjekoligjor; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);

- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes; (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

ç) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes;
- (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);
- Vërtetim mbi statusin që nuk shikojnë apo dëgjojnë; (Mund të shkarkohet nga e-albania ose të merret Vërtetim me vulë të njomë nga Njësia Administrative);

d) nxënësit, fëmijë të personit/personave (prindit/prindërve) që gëzojnë statusin e invalidit; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim mbi statusin e invaliditetit dhe pagesën e pensionit të invaliditetit të prindërve. (Mund të shkarkohet nga e-albania ose të merret tek Njësia Administrative);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);

- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);
- Vërtetim mbi statusin e viktimave të trafikimit;
- Vendim gjyqësor mbi humbjen e kujdestarisë prindërore;

ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);
- Vërtetim nga institucionet e sipërpërmendura për prindërit që kanë humbur jetën në krye të detyrës;

g) Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton. Dokumentat që nevojiten për të aplikuar janë:

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare, ku vërtetohet gjendja familjare me një prind gjallë e fëmijës/nxënësit (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë e vdekjes së prindit që nuk jeton;
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes. (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE, Vërtetim për individë të parregjistruar);

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

3/a) janë ndarë nga trugu familjar;

3/b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

3/c) deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jo kaluese;

Dokumentacioni që ka lidhje me rregjistrimin si punëkërkues i papunë për çdo anëtar madhor të familjes, vërtetimi mbi statusin e jetimit dhe pagesën e kujdestarisë si dhe vërtetimi mbi statusin e invaliditetit paraplegjik dhe pagesën e PAK, do i vendoset në dispozicion NSHMAÇ nga Drejtoria e Kujdesit Social.

Procedura për pranimin dhe shqyrimin e aplikimeve për bursa të realizohet sipas këtij rendi:

1. Procedura fillon me protokollimin e shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit pranë Bashkisë Korçë, në muajin Shtator.
2. Në datën 1 tetor bëhet afishimi i njoftimit në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë, në ambjentet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes dhe në të gjitha shkollat.
3. Brenda 25 ditëve nga afishimi i njoftimit drejtoritë e shkollave do të pranojnë aplikime për bursa.
4. Drejtoritë e shkollave për çdo aplikim duhet të mbajnë procesverbal dhe do e pranojnë dosjen e aplikantit vetëm nëse do të jetë e plotësuar nga ana formale me të gjitha dokumentat, bazuar në kriterin në të cilin klasifikohet nxënësi.
5. Në procesverbal do të pasqyrohet dhe data kur është dorëzuar dosja pranë drejtorisë së shkollës.
6. Pas përfundimit të afatit të njoftimit drejtorët e shkollave do të dorëzojnë me procesverbal pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes të gjithë dokumentacionin e mbledhur.
7. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga shkollat Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes do të përcjellë me shkresë numrin e aplikimeve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
8. Nga drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes do të ngrihet grupi i punës i cili do të verifikojë nga ana formale dhe e vlefshmërisë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar dhe do të përgatitë listën e përfituesve të bursave.
9. Në rast se numri i përfituesve ,sipas listës së sipërpërmendur ,është më i lartë se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, do të përfitojnë bursë ata nxënës që kanë dorëzuar më parë aplikimin pranë shkollës.
10. Rast pas rasti, në varësi dhe të buxhetit , Bashkia mund të mbështesë me bursa ata aplikantë të cilët nuk mbulohen nga fondi i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, por që dokumentacioni i dorëzuar prej tyre është i rregullt dhe brenda afatit të dorëzimit.

Për sa më sipër, bazuar në VKM-në nr.666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” e ndryshuar dhe në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë

dokumenatcionin dhe procedurën për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike.

Konceptoi: Sonjela Zguri

Kristina Zaçellari

Drejtori i NSHMAÇ-së

Ylli MUSAKA

Drejtoresha e Dr. së Përgjithshme Juridike

dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Anxhela DISHNICA (QERAMIXHI)

KRYETARI

Sotiraq FILO